




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ervehe Gashi
Rr. Myrvete Dida nr. 38
Prizren



VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2021/180 – Ervehe Gashi (Palë ankuese) kundër
TV Dukagjini (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 27 prill 2021 ka pranuar një Ankesë nga Pala ankuese ndaj OSHMA TV Dukagjini lidhur me transmetimin e emisioneve të Kallxo-Përnime me titull "Pazaret me hetime" të transmetuar me datat 7 dhe 12 prill 2021, si dhe edicionin qendror të lajmeve në TV Dukagjini të transmetuar më datën 10 prill 2021, përmes të cilit Pala ankuese pretendon se përmbajtja e këtij emisioni i ka cenuar rëndë dinjitetin dhe integritetin e saj personal dhe profesional.
3. KPM me datën 29 prill 2021, nëpërmes një shkrese e ka njoftuar TV Dukagjinin për ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda tre (3) ditësh të ofrojë një sqarim lidhur me të.
4. TV Dukagjini nuk ka ofruar ndonjë sqarim në lidhje me kërkesën e KPM-së.
5. KPM ka analizuar Ankesën e Palës ankuese dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 17 maj 2021 ka gjetur se TV Dukagjini nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

Analiza ligjore

6. Komisioni i KPM-së konstaton se TV Dukagjini, ndaj të cilit është parashtruar Ankesë, nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

7. KPM pretendimet e Palës ankuese i ka trajtuar në kuptimin e nenit 6, paragrafi 2 dhe 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 6, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënies politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.”

8. KPM gjatë monitorimit ka konstatuar se në kronikën ndaj të cilës është bërë Ankesë, TV Dukagjini ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. TV Dukagjini kronikën e ka balancuar, për faktin se gjatë transmetimit të emisioneve i ka ofruar mundësi edhe Palës ankuese dhe të tjerëve të ofrojnë pikëpamjet e tyre.

Neni 6, paragrafi 7, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim

9. KPM, duke marrë parasysh faktin se TV Dukagjini ka qenë pjesë në konferencën për shtyp të organizuar nga Pala ankuese e cila është transmetuar në emisionin e datës 12 prill 2021, dhe se gjatë kësaj konference ka parashtruar disa pyetje dhe ku Pala ankuese ka refuzuar të përgjigjet në pyetjet me arsyetimin se përgjigjet i ka dërguar me shkrim, konstaton se çështja e trajtuar nga TV Dukagjini është raportuar drejt pasi që Palës ankuese i ka dhënë mundësinë e sqarimit në lidhje me çështjen, mirëpo Pala ankuese ka refuzuar të paraqesë pikëpamjet e saj lidhur me rastin në fjalë.
10. KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, konstaton se TV Dukagjini nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 gjatë transmetimit të emisioneve të Kallxo-Përnime me titull *“Pazaret me hetime”*.

Vendim

11. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Palës ankuese, përmes së cilës pretendohet se OSHMA TV Dukagjini ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2 dhe 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
12. Udhëzohet Pala ankuese që me qëllim të kundërshtimit të përmbajtjes së emisioneve të transmetuara nga ana e OSHMA TV Dukagjini ta shfrytëzojë të drejtën e reagimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



26.05.2021
Datë